



Funded by  
the European Union

# SHËNDETI MENDOR NË SHKOLLA:

Një Dokument Politikash



Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit - IDEA 2022*, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

# SHËNDETI MENDOR NË SHKOLLA:

Një Dokument Politikash

# Përmbledhje Ekzekutive

Ky dokument u drejtohet politikëbërësve, qeverisë, organizatave dhe institucioneve të shëndetit mendor dhe arsimit në Kosovë. Rekomandimet e ofruara janë të orientuara në forcimin e sistemit arsimor të Kosovës për përmirësimin dhe promovimin e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve në shkolla.

# Shëndeti Mendor: Një Përkufizim

Shëndeti mendor mund të përkufizohet si një gjendje mirëqenieje në të cilën çdo individ realizon potencialin e tij/saj, mund të përballojë stresin normal të jetës, mund të punojë në mënyrë produktive dhe është në gjendje të kontribuojë në komunitetin e tij ose të saj.<sup>1</sup>

## Shëndeti Mendor i Fëmijëve


Shëndeti mendor i fëmijëve është një problem i theksuar i shëndetësisë publike në mbarë botën. Të zmadhuara nga pandemia, nevojat për intervenime dhe shërbime të duhura të shëndetit mendor për këtë kategori vazhdojnë të jenë tejet intensive. Në mungesë të programeve e shërbimeve të domosdoshme për adresimin e këtyre nevojave, këto të fundit kanë potencial të kalojnë në faza të krizës dhe të vazhdojnë të mbesin të deprivuara nga përmbushja e duhur. Raportohet që çdo i pesti fëmijë përjeton një gjendje të caktuar të shëndetit mendor brenda një viti, por vetëm 20% e tyre marrin trajtimin e nevojshëm.<sup>2</sup> Shumë prej atyre që tentojnë ta marrin ndihmën e nevojshme, ballafaqohen me sfida të shumta si pasojë e qasjes së limituar në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor mendor.

Me pandeminë e përcjellur nga mbyllja e shkollave, distancimi fizik, masat mbrojtëse dhe izolimi social, vlerat e siguruara tregojnë për rritje të niveleve të ankthit, depressionit, mendimeve për vetëvrasje dhe gjendjeve të tjera shoqëruese tek fëmijët.<sup>3</sup> Politikat dhe praktikatat të cilat hartohen si reagim drejt kësaj gjendjeje, duhet të jenë në përshtatje me përvojat e fëmijëve dhe të rinjve në përgjithësi, si dhe të udhëhequra nga një qasje intervenuese mbarë-strukturore. Këto praktika duhet të fillojnë nga ambientet ku fëmijët kalojnë më së shumti kohë, siç janë edhe shkollat.

Raportohet që çdo i pesti fëmijë përjeton një gjendje të caktuar të shëndetit mendor brenda një viti, por vetëm



e tyre marrin trajtimin e nevojshëm.



Integrimi i shëndetit mendor në politika mbarë-sektoriale, e sidomos në politika të arsimit, tregohet të jetë faktor kontribues pozitiv në shëndetin mendor të fëmijëve gjatë zhvillimit të tyre.

## Shëndeti Mendor në Arsim

Mjediset arsimore janë nga mjediset kryesore me potencialin më të lartë për promovim të shëndetit mendor optimal në rastet kur ato ofrojnë hapësirën dhe mundësitë e duhura për fëmijët dhe adoleshentët të cilët ndërveprojnë me këto mjedise. Për më shumë, shëndeti i mirë mendor del të jetë i ndërlidhur me rezultate më të mira në aspektin e edukimit dhe atë bihevioral.<sup>4</sup> Të dhënat e nxjerra nga konsultimet e realizuara me adoleshentë në vende të ndryshme të botës tregojnë që ata e shohin shkollën si një burim të rëndësishëm të vetëvlerësimit, socializimit, sigurisë emocionale, hapësirës për t'u distancuar nga ambientet e pashëndetshme shtëpiake dhe si një mjedis në të cilin mund ta ushqejnë nevojën e tyre për ta njohur botën më mirë.<sup>5</sup> Gjithsesi, disa nga adoleshentët që ishin pjesë e këtyre konsultimeve raportuan edhe për një perceptim të përbërë nga vlerësimi i shkollës si një mjedis në të cilin ata mund të përjetojnë dhunë, abuzim dhe presion të lartë akademik, duke raportuar edhe për përvoja të ndryshme të pakëndshme në këto mjedise si rezultat i dallimeve gjinore.<sup>5</sup>

Integrimi i shëndetit mendor në politika mbarësektoriale, e sidomos në politika të arsimit, tregohet të jetë faktor kontribues pozitiv në shëndetin mendor të fëmijëve gjatë zhvillimit të tyre. Pavarësisht nevojshmërisë dhe efektit të dëshmuar, vetëm një numër i vogël i fëmijëve dhe adoleshentëve marrin shërbimet e nevojshme në mjediset e shkollës.

# Shëndeti Mendor në Arsim: Shtrirja e Problemit në Kontekstin e Kosovës

Për dallim nga vendet e ndryshme në rajon dhe në botë të cilat e prioritojnë kujdesin shëndetësor mendor të nxënësve në shkolla, Kosova ende ka mungesa të theksuara në rregullimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve të nevojshme psikologjike në këto mjedise. Përveç mungesës së shërbimeve psikologjike me bazë në shkollë, mungesa e të dhënave për gjendjen e shëndetit mendor të nxënësve në shkolla në nivel vendi është një problematikë tjetër qenësore e cila penalizon bindshëm procesin e hartimit të politikave dhe intervenimeve të bazuara në evidencë.

Në anën tjetër, nga ato pak të dhëna ekzistuese që kemi, rezultatet tregojnë për prezencë shqetësuese të dhunës psikologjike në shkollat e Kosovës dhe dëshmojnë qartë nevojën për hulumtime dhe intervenime në këtë drejtim (Kosovar Youth Council, 2022)<sup>6</sup>. Duke qenë se mësimdhënësit janë kontakti i parë i nxënësve, hipotetikiht janë burimi më i sigurt për adresimin e problemeve të shëndetit mendor. Por, marrëdhëniet e nevojshme dhe të domosdoshme në mes të mësimdhënësve dhe nxënësve në Kosovë janë shumë më të ulëta sesa në vendet tjera në botë. Më konkretisht, raportohet që koha që një mësimdhënës mund ta kalojë më një nxënës për një orë mësimore është përafërisht një minut, kohë kjo e pamjaftueshme për të siguruar ndërveprimin e nevojshëm në këto mjedise.<sup>7</sup>

Gjersa në vende të ndryshme në rajon dhe në botë një numër i madh i psikologëve shkollorë janë të përfshirë në proceset kyçe të rregullimit të klimës psikosociale dhe arsimore në shkolla, e sidomos brenda klasave, Kosova ka një numër tejet të ulët të psikologëve shkollorë të angazhuar në shkolla dhe një infrastrukturë ligjore e cila ofron mundësi të limituara për avancimin të këtij profesioni dhe transmetim të kontributit të pritur e synuar nga këta profesionistë.



Duke qenë se mësimdhënësit janë kontakti i parë i nxënësve, hipotetikiht janë burimi më i sigurtë për adresimin e problemeve të shëndetit mendor.

# Baza Ligjore për Shërbimet Psikologjike në Sistemin Arsimor Parauniversitar në Kosovë

Në rastet kur shkollat kanë më pak se

**1000**  
nxënës

psikologët apo pedagogët udhëzohen për ta përmbushur normën e nevojshme në dy apo tre shkolla të tjera.

Profesioni i psikologut shkollor është i rregulluar sipas Udhëzimit Administrativ nr. 34/2014 me titullin “Funkcionimi i shërbimit pedagogjik - psikologjik në shkolla”. Ky udhëzim administrativ ka bazë ligjore ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Si i tillë, ai flet për shërbimet psikologjike dhe pedagogjike si njësi konsulore në kuadër të personelit profesional jomësimdhënës. Pavarësisht faktit që këto dy profile kanë përgjegjësi dhe detyra të ndryshme, në praktikë raportohen ngatërime të roleve.<sup>8</sup>

Kurse, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.26/2013,<sup>9</sup> të gjitha shkollat në Kosovë të cilat kanë mbi 1000 nxënës, duhet të kenë psikologë shkollorë, detyrat e të cilëve, poashtu të rregulluara me udhëzim administrativ, janë sipërfaqësisht të përkufizuara. Si rezultat, forma e angazhimit dhe detyrat e psikologëve të shkollës përcaktohen nga shkollat në të cilat ata janë angazhuar dhe rrjedhimisht janë të ndryshme në shkolla të ndryshme në vend.

Në rastet kur shkollat kanë më pak se 1000 nxënës, psikologët apo pedagogët udhëzohen për ta përmbushur normën e nevojshme në dy apo tre shkolla të tjera. Kjo shpërndarje konsiderohet të jetë e një kapaciteti të lartë dëmtues në ofrimin e përkushtimit të nevojshëm për sigurim të shërbimeve adekuate në shkolla.

Përveç angazhimit në realizimin e seancave me nxënës, hartimit dhe realizimit të aktiviteve të ndryshme, bashkëpunimit me pedagogë, mësimdhënës, prindër e grupe të tjera me rëndësi, hulumtime, vlerësime dhe intervenime të tjera, psikologët shkollorë angazhohen edhe në punë administrative të shkollave përkatëse.

Për të mos mjaftuar këto limitime në aspektin ligjor, Kosova ka po ashtu mungesë të një baze ligjore e cila rregullon licencimin e psikologëve shkollorë dhe përkufizimin e respektimin e standardeve profesionale të psikologëve shkollorë. Ngjashëm, praktikat aktuale nuk përfshijnë ndonjë mbikëqyrje profesionale të punës së psikologëve në shkolla. Për t'i adresuar këto çështje me rëndësi, simpoziumi i shëndetit mendor në shkolla vjen në rrjedhën e përpjekjeve të shoqërisë civile për mirësjellim të sifdave e mundësive për përmirësim të shëndetit mendor në shkolla.



# Simpoziumi i Shëndetit Mendor në Shkolla “Shkolla në Mendje”

Me 10 tetor, në Ditën Botërore të Shëndetit Mendor, Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM) dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) kanë organizuar Simpoziumin e Parë të Shëndetit Mendor në Shkolla. Ky simpozium ka trajtuar temën e mirëqenies psikologjike të nxënësve në shkollat e Kosovës duke zhvilluar tri panele të ndryshme të diskutimit me përfaqësues të profileve dhe institucioneve relevante në vend. Diskutimet dhe aktivitetet përcjellëse janë përpjekur ta ofrojnë një perspektivë të detajuar të ngecjeve, sfidave, mundësive dhe programeve të ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor në shkollat e Kosovës.

## Paneli i Parë: Shteti dhe Mendja

Me qëllimin primar të adresimit të çështjes së legjislacionit ekzistues mbi shëndetin mendor dhe barrierave në ofrimin e shërbimeve përkatëse psikosociale, të ftuar në këtë panel ishin prof. ass. dr. Fitim Uka, deputet në Kuvenin e Kosovës dhe z. Vebi Mujku, udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë. Përveç theksimit të pazbatueshmërisë së ligjit të shëndetit mendor në Kosovë, në këtë panel u adresuan edhe kërkesat e larta të shoqërisë për marrje të shërbimeve psikosociale në raste nevojë.

Të dy këto çështje, të një natyre tejet të rëndësishme e shqetësuese, shpjeguan rrjedhimisht ngecjen e njëres dhe tjetrës në adresimin e shëndetit mendor të qytetarëve në kapacitet e duhura. Po ashtu, ngecjet, mungesat dhe rekomandimet në raport me udhëzimin administrativ për përfshirjen e psikologëve në shkolla ishin pjesë e përmbajtjes së diskutimit të realizuar. Për më shumë, rregullimi me ligj i shërbimeve të shëndetit mendor, integrimi i shëndetit mendor në politikat tjera me rëndësi, rritja e kapaciteteve të shërbimeve dhe monitorimi e përmirësimi i performancës së këtyre shërbimeve, ishin disa nga rekomandimet kryesore të këtij paneli.



Përveç theksimit të pazbatueshmërisë së ligjit të shëndetit mendor në Kosovë, në këtë panel u adresuan edhe kërkesat e larta të shoqërisë për marrje të shërbimeve psikosociale në raste nevojë.



Panelistët adresuan nivelet prezente të stigmës në lidhje me shëndetin mendor tek shumica e grupeve në shoqëri, duke e vlerësuar kështu stigmën si një faktor rrezikues në adresimin dhe përmbushjen e nevojave për një mirëqenie optimale psikologjike.

## Paneli i Dytë: Arsimi dhe Mendja

Paneli “Arsimi dhe Mendja” është munduar që ta diskutojë më në detaje temën e mirëqenies psikologjike nga perspektiva e shkollave, akademisë dhe ekipeve multidisciplinare në Kosovë. Për më shumë, gjatë panelit është diskutuar se cili është potenciali i Kosovës për t’i adresuar problemet e shëndetit mendor në shkolla dhe sa jemi duke përgatitur mësimdhënës, psikologë dhe ekipe mbështetëse që mund t’i plotësojnë nevojat e komunitetit. Të ftuar në këtë panel ishin: Prof. Dr. Aliriza Arënliu nga Departamenti i Psikologjisë, Prof. Ass. Dr. Blerta Perolli Shehu nga Fakulteti i Edukimit; Lirie Lokaj nga GIZ, Valdet Plakolli, Psikolog Shkollor dhe Miran Xhelili, Logoped. Panelistët adresuan nivelet prezente të stigmës në lidhje me shëndetin mendor tek shumica e grupeve në shoqëri, duke e vlerësuar kështu stigmën si një faktor rrezikues në adresimin dhe përmbushjen e nevojave për një mirëqenie optimale psikologjike. Me një valencë pozitive u raportua përgatitja e psikologëve shkollorë, ku tregohet për një profil të realizuar mirë dhe në përputhje me kërkesat që do të duhet të specifikoheshin në udhëzimin përkatës administrativ. Plotësimi i programeve akademike në Fakultetin e Edukimit me lëndë nga fusha e psikologjisë u prezantua si një nga reformat tashmë të ndërmarra në Universitetin e Prishtinës. Gjithsesi, rritja e shërbimeve me bazë në shkollë, avancimi i profilit të psikologut, pedagogut dhe logopedit në raport me shërbimet psikologjike shkollore, ngritja e ndërgjegjësimit përmes intervenimeve të edukimit publik dhe krijimi i programeve tjera parandaluese dhe intervenuese, ishin disa nga rekomandimet e derivuara nga ky panel.

## Paneli i tretë: Komuniteti dhe Mendja

Paneli “Komuniteti dhe Mendja” është munduar të shërbejë si një hapësirë për shpалosjen e programeve, projekteve, shërbimeve dhe iniciativave të ndryshme me bazë në komunitet në fushën e shëndetit mendor në shkolla dhe mirëqenies në përgjithësi. Të ftuarit e këtij paneli ishin: Selvi Izeti-Çarkaxhiu (KRCT), Egzon Gashi (Teach for Kosova), Ardiana Lahu (TOKA), Ditjon Fetahu (KYC), Saranda Rexha (Stress Free Corner) dhe Veronë Perçuku (QHPSM). Në këtë panel u diskutuan çështjet e rëndësisë së barazisë në arsim, mungesës së përkrahjes institucionale të iniciativave të shoqërisë civile, mungesës së theksuar të hulumtimeve dhe të dhënave për gjendjen e shëndetit mendor në vend, rëndësisë së qasjeve intervenuese të informuara mbi traumë, shkeljes të të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në institucionet e shëndetit mendor, mungesës së sigurisë fizike, emocionale e psikologjike të nxënësve në shkolla dhe shtëpi, si dhe ato të sfidave të shtresuara psikosociale gjatë pandemisë Covid-19.



Në këtë panel u diskutuan çështjet e rëndësisë së barazisë në arsim, mungesës së përkrahjes institucionale të iniciativave të shoqërisë civile, etj.

# Rekomandime

## Rekomandimet për Institucionet Politikëbërëse

- Të bëhet ndryshim-plotësimi i Udhëzimit Administrativ 26/2013 për angazhimin e psikologëve shkollorë në raport me numrin e nxënësve në shkolla, duke ulur kriterin e angazhimit në 1 psikolog për 600 nxënës dhe duke paraparë alternativat e ofrimit të shërbimeve në shkollat më të vogla, ku numri i nxënësve nuk arrin numrin 600.
- Të bëhet rishqyrtimi i detyrave dhe përgjegjësi të psikologëve shkollorë në një udhëzim administrativ të veçantë nga udhëzimi administrativ aktual 34/2014 për rolin e psikologut dhe pedagogut në shkolla.
- Të rregullohet me ligj procesi i mbikëqyrjes profesionale të psikologëve shkollorë dhe rrjedhmisht të krijohen grupe mbikëqyrëse dhe mbështetëse për psikologët shkollorë.
- Të rregullohet me ligj procesi i licencimit të psikologëve shkollorë duke i përcaktuar qartë modalitetet e licencimit të parë dhe ato të rilicencimit.
- Të zhvillohen strategji dhe programe për parandalim të vetëvrasjes tek fëmijët dhe të rinjtë të cilat përfshijnë ndërgjegjësimin, intervenimin, trajnimin e nevojshëm dhe shërbimet përkatëse përkrahëse.
- Të rritet përkrahja institucionale në realizimin e hulumtimeve në nivel kombëtar mbi gjendjen e shëndetit mendor në shkolla përmes bashkëpunimit të institucioneve akademike dhe atyre hulumtuese.

## Rekomandimet për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Shkollat e Kosovës

- Të përfshihet promovimi i shëndetit mendor në kurrikulat e shkollës si qasje e integruar në lëndët aktuale.
- Të integrohen qasjet e informuara mbi traumë në proceset e mësimdhënies dhe ndërveprimit me nxënës në shkolla, përmes trajnimeve të stafit shkollor dhe përgatitjes së stafit mësimor.
- Të bëhet trajnimi i stafit shkollor në ofrimin e përkrahjes së duhur psiko-emocionale të nxënësve në shkolla përmes trajnimit për ofrimin e ndihmës së parë psikologjike dhe ndihmës së parë të shëndetit mendor.

- Të rritet niveli i përfshirjes së nxënësve, prindërve dhe kujdestarëve në dizajnimin e mjediseve shkollore me qëllim të ofrimit të një ambienti të rehatshëm, motivues dhe të sigurt.

## Rekomandimet për Institucionet e Shëndetit Mendor

- Të bëhet rishqyrtimi dhe specifikimi i profileve të shërbimeve të shëndetit mendor me bazë në komunitet, duke përmirësuar infrastrukturën ligjore dhe avancimin e proceseve komunikuese dhe referuese ndërmjet institucioneve përkatëse.
- Të krijohet një sistem i avancimit profesional të psikologëve shkollore për administrimin e testeve për vlerësim, identifikim dhe intervenim në shkolla.
- Të rritet qasshmëria dhe cilësia e shërbimeve të shëndetit mendor me bazë në shkollë dhe komunitet për fëmijët dhe adoleshentët në nevojë për ndihmë dhe mbështetje psikologjike përmes rritjes së numrit të programeve dhe qendrave për shëndet mendor të fëmijëve, si dhe stafit jomësimitor në shkolla.

# Përmbyllje

Shëndeti mendor në shkolla është një çështje komplekse e cila për adresim të mirëfilltë duhet të trajtohet nga nivele e perspektiva të ndryshme. Pavarësisht këtij kompleksiteti, qëllimi udhëheqës është sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve për të gjithë nxënësit në shkolla në mënyrë që të mund të përkrahet shëndeti dhe mirëqenia e tyre psikosociale. Paralelisht me rritjen e numrit të shërbimeve psikologjike shkollore është mëse i nevojshëm edhe përmirësimi i efektivitetit të atyre ekzistuese. Shëndeti mendor duhet ta marrë vëmendjen e domosdoshme dhe integrimi i tij në politika mbarë-sektoriale duhet të jetë prioritet për politikëbërësit dhe grupet tjera relevante.

# Referencat

- 1 World Health Organisation (2001). The world health report—Mental health: New understanding, new hope. Geneva: World Health Organisation.
- 2 National Research Council and Institute of Medicine. (2009). *Preventing Mental, Emotional, and Behavioral Disorders Among Young People: Progress and Possibilities*. O'Connell, T. Boat, & K. E. Warner Eds. Washington, DC. The National Academic Press.
- 3 [https://www.bakercenter.org/application/files/6316/4753/1314/impact\\_of\\_the\\_covid-19\\_pandemic\\_on\\_children\\_youth\\_and\\_families\\_2.pdf](https://www.bakercenter.org/application/files/6316/4753/1314/impact_of_the_covid-19_pandemic_on_children_youth_and_families_2.pdf)
- 4 Corcoran, R. P., Cheung, A. C., Kim, E., & Xie, C. (2018). Effective universal school-based social and emotional learning programs for improving academic achievement: A systematic review and meta-analysis of 50 years of research. *Educational Research Review*, 25, 56-72.
- 5 Johns Hopkins Bloomberg School of Public Health & United Nations Children's Fund (2022). On My Mind: How adolescents experience and perceive mental health around the world.
- 6 Musliu, A. & Frenzel, A. (2022, in press). Measuring Teacher Emotions.
- 7 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2014). Udhëzimi administrativ Nr. 34/2014 për Funkcionimin e Shërbimeve PedagogjikePsikologjike në shkolla. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-34-2014.pdf>
- 8 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2013). Udhëzimi administrativ Nr. 26/2013 për Zgjedhjen e Nëpunësve në Ofrimin e Shërbimeve Profesionale në Institucionet Edkuativo-Arsimore Parauniversitare. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/26-2013-ua.pdf>







